



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:087074  
Datë: 02.05.2024  
Numri i dokumentit: 05646063

**K.DH.SH.II.nr.373/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhomat e shkalles se dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.P “Termokos“ Sh.A, me NUI 810514829, me seli ne rr.”28 Nëntori” nr.181 Lagja “Dardania” ne Prishtinë, ndaj debitorit Ndërmarrja Publike Banesore (NPB) sh.a, me seli ne rr.“Kroi i Bardh” H A/1 nr.15 ne Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkalles se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1283/23 dt.30.10.2023, me datë 02.05.2024, mori këtë:

#### A K T V E N D I M

I. APROVOHET si e themeltë ankesa e kreditorit N.P “Termokos“ sh.a, me NUI 810514829, me seli ne rr.”28 Nëntori” nr.181 Lagja “Dardania” ne Prishtinë, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1283/23 dt.30.10.2023, ashtu që çështja gjykohet si në vijim: REFUZOHET prapësimi i debitorit Ndërmarrja Publike Banesore (NPB) sh.a, me seli ne rr. “Kroi i Bardh” H A/1 nr.15, ne Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbartimit P.nr.521/2021 dt.13.10.2021, si i pa bazuar, MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr. 521/2021 dt.13.10.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat, Prishtinë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

#### A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1283/23 dt.30.10.2023, e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit Ndërmarrja Publike Banesore (NPB) sh.a, me seli ne rr. “Kroi i Bardh” H A/1 nr.15, ne Prishtinë, dhe ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.521/2021 dt.13.10.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat, me seli ne Prishtinë si dhe ka përfunduar ne tërësi procedurën ne këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi, ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljes së dispozitave ligjore, vlerësimit të gabuar të gjendjes faktike dhe të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë aktvendimin e atakuar ta anuloj dhe çështjen ta kthejë në shkallë të parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e themeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori N.P “Termokos“ sh.A, me NUI 810514829, me seli në rr.”28 Nëntori” nr.181 Lagja “Dardania” në Prishtinë, me datën 13.10.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Ndërmarrja Publike Banesore (NPB) sh.a, me seli në rr. “Kroi i Bardh” H A/1 nr.15, në Prishtinë, në bazë të Ekstraktit të verifikuar nga librat afariste, si dokument i besueshëm me shifër nr.011315 dt.12.10.2021. Përmbartuesi Privat Arsim Bajraktari Prishtinë, sipas propozimit të kreditorit, ka nxjerrë Urdhrin përmbartimor P.nr.521/2021 dt.13.10.2021, me të cilin e ka detyruar debitorin që në emër të borxhit për ofrimin e shërbimeve të ngrohjes, kreditorit të paguaj shumën prej 502.51 euro, me kamatë prej 8% në vit, nga data kur kredia është bërë e arritshme e deri të pagesa definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri.

Kundër urdhrin përmbartimor, debitori ka paraqitur prapësim me datën 15.04.2022, me pretendimin se kreditori nuk ia ka dorëzuar debitorit as ekstraktin nga librat e kontabilitetit e as faturën e pagesës me borxhin e pretenduar, shton se nuk e ka pasur në shfrytëzim banesën në rr. “Kroi i Bardh” H A/1 nr.15, në Prishtinë dhe debitori as nuk e ka shfrytëzuar shërbimet e ngrohjes për periudhën kontestuese prej datës 31.10.2018 deri më 30.04.2021. Deklaron se për më tepër kërkesa për pagesën e borxhit të lartcekur për periudhën 2018, 2019, 2020, 2021 është parashkruar në kuptim të dispozitave të nenit 360 par.1 nenpar.1.1 e LMD, propozon që gjykata ta anuloj urdhrin përmbartimor dhe të abrogojë të gjitha veprimet e ndërmarra.

Ndaj prapësimin të debitorit, kreditori me datën 20.04.2022, ka ushtruar përgjigje, me arsyetimin se kreditori për periudhën prej 2015-2022 sipas të dhënave nga arkiva nuk posedon asnjë kërkesë apo njoftim për të ndaluar faturimin e banesës e cila gjendet në adresën Kroi i Bardhë H A/1 nr.15 në Dardani Prishtinë, vlen të ceket se debitori edhe pas largimit të shfrytëzuesit-uzurpatorit për muajt Tetor, Nëntor, Dhjetor 2021, Janar, Shkurt, Mars 2022 nuk i ka paguar faturat që e nënkupton se është i papërgjegjshëm në kryerje të obligimeve. Nuk qëndron pretendimi i debitorit se detyrimi është parashkruar bazuar në nenin 360 pika 1.1 e LMD, propozon që gjykata që prapësimin e debitorit të refuzohet.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar me të cilin ka vendosur më decidivisht

si në dispozitiv të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kartela e kontabilitetit nr.011315 ne baze te cilës është lejuar përbarimi nuk plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe 37 te LPP, sepse e njëjta me nenin 29 par.1 nenpar.1.2 te LPP nuk është përcaktuar si dokument i besueshëm dhe si rrjedhojë edhe urdhri përbarimor duhet te anulohet dhe procedura te përfundohet ne tërësi. Meqë dokumenti ne bazë te cilit është lejuar përbarimi nuk është dokument i besueshëm gjykata vendosi qe pretendimet e debitorit te paraqitura ne prapësim dhe kreditorit ne përgjigje ne prapësim te mos i shqyrtoj fare, ashtu qe bazuar ne nenin 1, 73 dhe nenin 12 par.2 te Ligjit nr.05/L-118 për ndryshim te ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore vendosi si ne dispozitiv te aktvendimit.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata Komerciale –Dhoma e shkalles se dytë vlerëson se nuk mund ta pranoj përfundimin dhe qëndrimin juridik te gjykatës së shkallës së parë pasi gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar ashtu qe edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Gjykata e shkalles se dytë ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në këtë rast gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar ne kuptim te dispozitës se nenit 29 par.1, pika 1.4 te LPP-së si dhe nenit 355 par.1 dhe 2 te LPK, kjo pasi që nuk janë dhënë vlerësime te drejta në përputhje me dispozitat ligjore dhe gjendjen faktike mbi atë çka përmbajnë shkresat ne lëndë, e mbi te cilat mund të iniciohet procedura e përbarimit.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkalles se Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka konstatuar drejtë me vlerësimin se dokumenti mbi bazën e te cilit është lejuar përbarimi nuk mund te pranohet si dokument i besueshëm.

Kjo gjykatë vlerëson se dokumenti mbi bazën e te cilit është lejuar përbarimi me numër nr.011315 dt.12.10.202, është dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përbarim konform dispozitave te nenit 29 par.1 nenpar.1.4 te LPP i cili parasheh se dokumente te besueshme janë edhe: dokumentet qe sipas dispozitave ligjore te posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike dhe se ne rastin konkret marrë për bazë faktin se NP “Termokos” Sh.a, është Ndërmarrje Publike për ofrim te shërbimeve te ngrohjes për qytetarë, atëherë Kartela e nxjerr nga librat e kontabilitetit te kësaj ndërmarrje publike konsiderohet dokument me rendësi publike.

Gjykata e shkallës se dytë ne analizë te çështjes dhe pretendimeve ne prapësim te debitorit se borxhi i kërkuar nga kreditori është parashkuar, gjë qe ky pretendim nuk është shqyrtuar nga gjykata e shkalles se parë, vlerëson se ky pretendim është i pabazuar dhe nuk qëndron sepse sipas dokumentit te besueshëm, borxhi i kërkuar është nga data 31.10.2018 ne shumen prej 502.51 euro ndërsa marrë për bazë se propozimi për përbarim është ushtruar me datën 13.10.2021 rezulton se nuk kemi te bëjmë me parashkrim sepse nuk ka kaluar afati 3 vjeçar i parashkrimit ashtu siç parashihet me nenin 355 par.1 i cili përcakton se *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite, dhe par.2 i këtij neni, cili parasheh qe “Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”*, shtu këtu faktin tjetër se

palët ne procedure janë subjekte juridike dhe jo persona fizik ose amvisëri, çka del se nuk kemi te bëjmë me parashkrim te detyrimit te kërkuar nga kreditori.

Prandaj, vlerësuar si me lartë, gjykata e shkalles se dytë nuk e ka pranuar si të drejtë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se dokumenti mbi te cilin është bërë përmbarimi me dispozitat ligjore nuk është plotëson kushtet ligjore për te qenë dokument i besueshëm konform dispozitave ligjore.

Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhomat e Shkalles se Dytë, vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjënë se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore qe aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për lejimin e përmbarimit nga ana e Përmbaruesit Privat Arsim Bajraktari - Prishtinë.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale- Dhomat e shkallës se dytë, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual, bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkalles se Dytë

K.DH.SH.II nr. 373/24, me datë 02.05.2024

Gjyqtari  
Ramush Bardiqi